

Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave 2018



Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4	Komuna e Gjakovës	15
Metodologjia	5	Komuna e Kamenicës	16
Indeksi i transparencës buxhetore komunale 2018	7	Komuna e Gjiçanit	17
Krahasim: Indeksi 2017 dhe 2018	10	Komuna e Hanit të Elezit	18
Përfundime dhe rekomandime	13	Komuna e Shtimes	19
Anekset	14	Komuna e Lipjanit	20
		Komuna e Prishtinës	21
		Komuna e Mitrovicës	22
		Komuna e Pejës	23
		Komuna e Prizrenit	24
		Komuna e Vushtrrisë	25
		Komuna e Suharekës	26
		Komuna e Drenasit	27
		Komuna e Obiliqit	28
		Komuna e Skenderajit	29
		Komuna e Fushë Kosovës	30
		Komuna e Istogut	31
		Komuna e Rahovecit	32
		Komuna e Kaçanikut	33
		Komuna e Vitisë	34
		Komuna e Malishevës	35
		Komuna e Dragashit	36
		Komuna e Klinës	37
		Komuna e Graçanicës	38
		Komuna e Ferizajit	39
		Komuna e Mamushës	40
		Komuna e Podujevës	41
		Komuna e Junikut	42
		Komuna e Shtërpçës	43
		Komuna e Mitrovicës Veriore	44
		Komuna e Ranillugut	45
		Komuna e Deçanit	46
		Komuna e Novobërdës	47
		Komuna e Klllokotit	48

Përmbledhje ekzekutive

Transparenca buxhetore e komunave e rrit llogaridhënien rreth shpenzimit të parasë publike. Publikimi i dokumenteve të rëndësishme buxhetore në formate që lejojnë përdorim të lehtë të të dhënave ndikon në përfshirjen e palëve, sikurse organizatave të shoqërisë civile, qytetarëve dhe institucioneve tjera, në monitorimin dhe analizimin e dokumenteve buxhetore. Në vitin 2018, komunat kanë publikuar një numër më të madh të dokumenteve buxhetore dhe kanë organizuar më shumë dëgjime buxhetore sesa në dy vitet e kaluara, që tregon një trend pozitiv të hapjes së komunave sa i përket shpenzimit të parasë publike.

Rezultatet e indeksit të Institutit GAP për vitin 2018 tregojnë një nivel mbi mesatar të transparencës buxhetore të komunave, ku 27 nga 38 komuna kanë mbledhur 50 pikë ose më shumë në indeks. Në vitin 2017, vetëm 17 nga 38 komuna kishin mbledhur 50 pikë ose më shumë në indeks ndërsa më 2016 vetëm 16 nga 38 komuna e kishin arritur këtë rezultat. Komunat me transparencën më të lartë buxhetore më 2018 janë Gjakova (97 pikë), Kamenica (88 pikë) dhe Gjlani (78.5 pikë). Ndërsa, komunat e Zubin Potokut, Parteshit, Leposaviqit dhe Zveçanit nuk kanë mbledhur asnjë pikë në indeks, duke mos publikuar asnjë dokument buxhetor apo organizuar ndonjë dëgjim buxhetor me qytetarë. Numri më i madh i dokumenteve pjesë e indeksit janë në formatin Excel (44%), një pjesë tjetër më e vogël në formatin PDF i skanuar (27%) dhe PDF (22%). Ndërsa, sa i përket formës së qasjes në dokumente, 93% janë dokumente të publikuara nëpër uebfaqe të komunave, ndërsa 7% janë dokumente të pranuar përmes kërkesave tona drejtuar komunave. Mirëpo, jo të gjitha komunat i kanë publikuar dokumentet bazike që burojnë nga legjislacioni lidhur me transparencën në komuna. Për secilin nga këto dokumente, janë nga 10 komuna të cilat nuk i kanë publikuar ato dhe janë 18 komuna të cilat nuk janë përgjigjur fare në kërkesat e Institutit GAP për qasje në dokumente.

Raporti ofron edhe vlerësim individual të komunave rreth transparencës buxhetore si dhe paraqet disa rekomandime sa i përket përmirësimit të gjendjes aktuale.

Metodologjia

Për të vlerësuar transparencën buxhetore në komuna më 2018, Instituti GAP sikurse edhe në dy vitet e kaluara ka hartuar një indeks që përbëhet nga 100 pikë të shpërndara në 14 dokumente buxhetore, rregullore, lista të përfituesve të subvencioneve dhe dëgjime buxhetore. Përveç dokumenteve të cilat komunat duhet t'i publikojnë bazuar në legjislacionin në fuqi, indeksi përmban dhe dokumente tjera buxhetore të cilat u ofrojnë qytetarëve informacione më të shumta rreth shpenzimit të parasë publike. Ndërsa, numri i pikëve për secilin dokument është vendosur në raport me rëndësinë që kanë ato dokumente në rritjen e transparencës buxhetore dhe janë të njëjta për të gjitha komunat.

Tabela 1. Vlerësimi me pikë i komunave për publikimin e dokumenteve sipas Institutit GAP

Dokumenti	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	5	3.5	2.5	1.5
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	5	3.5	2.5	1.5
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	5	3.5	2.5	1.5
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	15	10.5	7.5	4.5
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	5	3.5	2.5	1.5
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	5	5	1.5
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	10	7	5	5
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	20	14	10	10
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	2.5	2.5	2.5
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	2.5	2.5	2.5
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	2.5	2.5	2.5
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	2.5	2.5	2.5
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	10	7	5	3
Kontratat e nënshkruara 2018	10	10	10	10

Për dallim nga indeksi i vitit të kaluar, në indeksin për vitin 2018 komunat të cilat kanë filluar të publikojnë kontratat e nënshkruara, marrin 10 pikë, ndërsa është larguar nga indeksi dokumenti i raportit të auditorit të brendshëm. Ky dokument është larguar pasi që shumë nga departamentet e auditimit të brendshëm të komunave kanë pasur mëdyshje nëse në bazë të legjislacionit në fuqi u lejohet që të publikojnë këtë raport, edhe pse baza ligjore nuk e ndalon një gjë të tillë.¹ Të gjitha dokumentet e publikuara në format të lexueshëm nga kompjuteri siç janë Microsoft Excel apo Word janë vlerësuar me maksimumin e pikëve. Përgjatë në këtë kriter bëjnë rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e publikuara, të cilat marrin pikë të njëjta për cilindo format pasi që përmbajtja e tyre është kryesisht tekstuale. Dokumentet e publikuara në formatin PDF janë vlerësuar me 30% pikë më pak, ndërsa publikimi i dokumenteve të skanuara është vlerësuar me 50% pikë më pak. Në rast se një dokument nuk është publikuar fare në faqen zyrtare të komunës, mirëpo komuna

¹ Bazuar në Ligjin nr. 03/L-128 për Auditim të Brendshëm dhe Ligjin nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike publikimi i raportit të Auditorit të Brendshëm nuk është i ndaluar shprehimisht.

është përgjigjur në kërkesën tonë, atëherë kjo është vlerësuar me 70% pikë më pak. Përrjashtim në uljen e pikëve prej 70% për dokumentet e dërguara me kërkesë bëjnë Kartela Analitike e Kontos, kontratat e publikuara dhe lista e përfituesve të subvencioneve – kjo për shkak që këto nuk janë ende obligime ligjore për publikim të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Po ashtu, ky indeks nuk bën vlerësimin e cilësisë së dokumenteve të publikuara. Pra, një komunë mund të merr maksimumin e pikëve vetëm në rast se i ka publikuar të gjitha dokumentet në faqen e internetit në formatin Excel dhe ka organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore.

Mbledhja e të dhënave për publikimin e dokumenteve është bërë duke kërkuar nga komunat që të plotësojnë një dokument me linqet/vegzat e dokumenteve të publikuara në faqen e komunës. Kërkesa është dërguar në emailin zyrtar të komunës për komunikim me publikun në qershor 2019, ndërsa monitorimi i faqeve të komunave nga Instituti GAP ka përfunduar në muajin gusht 2019. Për komunat të cilat nuk janë përgjigjur në kërkesën tonë, vlerësimi i indeksit është bërë në bazë të informatave që kemi mundur t'i gjejmë në ueb-faqet e tyre. Në rast se një dokument nuk gjendet në faqen e komunës me tri klikime dhe në fushën përkatëse të destinuar për raportet e buxhetit, atëherë nuk është marrë parasysh në vlerësim.

Transparenca e institucioneve publike, në këtë rast komunave, është plotësuar së fundmi përmes ndryshimeve në Ligjin për qasje në dokumente publike. Ligji thekson qartazi se lejohet gjithnjë qasja në dokumentet të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet e parasë publike dhe nxit institucionet që të publikojnë dokumentet në formatin elektronik, konkretisht në çfarëdo versioni që mundëson qasjen më të madhe të publikut. Po ashtu ligji i ri, për dallim nga i kaluari, përmban pjesën për të dhëna të hapura ku institucionet obligohen që në mënyrë proaktive të publikojnë çdo dokument publik të përfunduar, pavarësisht nëse qytetarët kanë bërë kërkesë për qasje në to ose jo. Për më shumë, institucionet duhet të publikojnë të dhëna të hapura që sipas ligjit duhet t'u mundësojnë qytetarëve përdorimin dhe krahasimin e të dhënave.²

Bazuar në udhëzimin administrativ të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal (MAPL) për transparencë në komuna 2018, komunat kanë për detyrë t'i publikojnë këto dokumente buxhetore: 1) planin e buxhetit dhe planet investuese; 2) raportet tre mujore të shpenzimeve; 3) kornizën afatmesme buxhetore (KAB); 4) raportin përmbledhës të buxhetit të komunës për vitin e kaluar fiskal; dhe 5) raportin e auditorit të përgjithshëm mbi buxhetin për vitin e kaluar fiskal.³ Udhëzimi i ri administrativ në fjalë nuk ka pësuar ndryshime nga udhëzimi administrativ i 2015 sa i përket dokumenteve buxhetore të cilat komunat janë të obliguara t'i publikojnë. Ndërsa, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i bën përgjegjës kryetarët e komunave për publikimin e raporteve tre mujore financiare të cilat duhet të publikohen në ueb-faqen e komunës 30 ditë pas përfundimit të tremujorit.⁴ Po ashtu, sipas këtij ligji, kuvendi komunal është i detyruar të mbajë dëgjime buxhetore me qytetarë në përputhje me aktet komunale.⁵ Kurse, udhëzimi administrativ i MAPL-së për transparencë në komuna përcakton se komunat përveç obligimit që t'i mbajnë të paktën dy dëgjime publike me qytetarë brenda vitit, duhet të organizojnë takime publike shtesë për buxhet dhe çështje tjera komunale.⁶ Po ashtu, në disa raste qarkoret buxhetore të hartuara nga Ministria e Financave (MF) e obligojnë kryetar-in/en e komunës që të shqyrtojë buxhetin me qytetarë.⁷

2 Ligji nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike. Burimi: <http://bit.ly/2Hf4zms>.

3 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Udhëzim administrativ nr. 04/2018 për transparencë në komuna. Burimi: <http://bit.ly/2KHJhAj>.

4 Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 45. Burimi: <http://bit.ly/2h3BfRW>.

5 Ibid. Neni 61.2.


6 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Udhëzim administrativ nr. 04/2018 për transparencë në komuna. Burimi: <http://bit.ly/2KHJhAj>.

7 Për më shumë detaje rreth bazës ligjore për transparencë buxhetore komunale shih indeksin e vitit 2016: <https://bit.ly/2Fkxdzj>.

Indeksi i transparencës buxhetore komunale 2018

Transparenca buxhetore e komunave në vitin 2018 ishte në një nivel më të lartë se në vitet e kaluara, ku mesatarja e pikëve për komunë ishte mbi 52 dhe 71% e komunave kanë mbledhur 50 pikë ose më shumë në indeks. Më 2017, vetëm 45% e komunave kishin mbledhur 50 pikë ose më shumë në indeks. Komuna me transparencën më të lartë buxhetore më 2018 është Gjakova, e cila ka mbledhur 97 pikë dhe ka publikuar të gjitha dokumentet buxhetore si dhe ka mbajtur të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarë. Pjesa më e madhe e dokumenteve buxhetore të publikuara nga komuna e Gjakovës janë në formatin Excel, duke përfshirë këtu dhe Kartelën Analitike të Kontos që përmban të dhëna të detajuara rreth shpenzimit të buxhetit të komunës. Po ashtu, transparencë të lartë buxhetore më 2018 bazuar në indeksin e GAP ka treguar dhe komuna e Kamenicës e cila ka mbledhur 88 pikë në indeks dhe ka publikuar të gjitha dokumentet, mirëpo për shkak të formatit të disa dokumenteve nuk ka marrë pikët maksimale. Ndërsa komuna e Zubin Potokut, Parteshit, Leposaviqit dhe Zveçanit janë vlerësuar me zero pikë në indeks ngase nuk kanë publikuar asnjë dokument dhe nuk janë përgjigjur në kërkesën e Institutit GAP për qasje në dokumentet buxhetore.

Figura 1. Indeksi për transparencë buxhetore komunale 2018




Përkundër që janë të obliguara ligjërisht që t'i publikojnë disa nga dokumentet buxhetore pjesë e indeksit, sikurse raportet financiare tremujore dhe ato vjetore, jo të gjitha komunat e kanë bërë këtë më 2018. Konkretisht, vetëm rreth 60% e komunave i kanë publikuar të gjitha dokumentet që burojnë nga udhëzimi administrativ i MAPL-së për transparencë në komuna. Për secilin nga këto dokumente janë nga 10 komuna të cilat nuk i kanë publikuar ato. Përjashtim këtu bën vetëm raporti financiar vjetor ku 33 nga 38 komuna e kanë publikuar atë. Ndërsa, edhe pse ka ndodhur një progres i vogël nga komunat në publikimin e dokumenteve të rëndësishme buxhetore, janë vetëm 8 komuna të cilat e kanë publikuar ose e kanë bërë të qashtëm në bazë të kërkesës, Kartelën Analitike të Kontos. Po ashtu, vetëm gjysma e komunave kanë treguar tendencë që t'i publikojnë kontratat e nënshkruara me subjekte të ndryshme.

Tabela 2. Përqindja e komunave që kanë publikuar dokumentet që përmban indeksi

Dokumenti	Përqindja e komunave
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	79%
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	76%
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	76%
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	87%
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	79%
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	79%
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	71%
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	21%
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	79%
Kontratat e nënshkruara 2018	58%

Komuna e Gjakovës, Shtimes dhe Lipjanit janë tri komunat që kanë publikuar shumicën e dokumenteve kryesore buxhetore në formatin Excel, që lejon përdorim më të lehtë të të dhënave brenda këtyre dokumenteve. Ndërsa, komuna e Malishevës, Mitrovicës dhe Ferizajt janë tri komunat që mbi 70% të dokumenteve buxhetore në ueb-faqet e tyre i publikojnë në formatin PDF dhe PDF i skanuar, çfarë e bën më të vështirë përdorimin e informacioneve në këto dokumente nga qytetarët.

Figura 2. Komunat që publikojnë më shumë nga dokumentet buxhetore në formatin Excel dhe ato në formatet PDF ose PDF i skanuar



Më 2018, bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, komunat së bashku kanë publikuar 266 dokumente buxhetore dhe kanë organizuar 109 dëgjime buxhetore. Numri më i madh i këtyre dokumenteve është i publikuar në formatin Excel (44%), një pjesë tjetër më e vogël në formatin PDF i skanuar (27%) dhe PDF (22%), dhe pjesa tjetër janë dërguar pas kërkesës së Institutit GAP për qasje në dokumente (7%). Raporti vjetor financiar, buxheti i planifikuar 2019, Korniza Afatmesme Buxhetore, rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe raportet financiare tremujore mbeten nga dokumentet që publikohen më shpesh nga komunat. Ndërsa, një numër më i vogël i komunave e publikojnë Kartelën Analitike të Kontos (8), kontratat e nënshkruara (21) dhe listat e përfituesve të subvencioneve (27).

Figura 3. Formati i dokumenteve të publikuara



Tabela 3. Dokumentet e publikuara të indeksit për transparencë buxhetore komunale 2018

Dokumenti	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa	Numri i Komunave
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	9	11	10	0	30
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	8	13	7	1	29
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	8	10	8	3	29
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	27	2	3	1	33
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	23	3	3	1	30
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	28	0	0	2	30
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	7	4	11	5	27
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	2	0	2	4	8
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	109	0	0	0	109 dëgjime b.
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	5	13	10	2	30
Kontratat e nënshkruara 2018	1	2	19	0	21

Krahasim: Indeksi 2017 dhe 2018

Për të vlerësuar progresin e komunave në rangimin në indeksin buxhetor, kemi vazhduar të përdorim të njëjtën mënyrë të vlerësimit ani pse disa dokumente nuk merren më parasysh. Siç ishte rasti vitin e kaluar, edhe këtë radhë, transparenca buxhetore në nivel komunal është rritur. Përderisa në vitin 2017 vetëm 45% e komunave kanë mbledhur 50 pikë ose më shumë në indeks, këtë vit janë 71% të komunave që kanë atë rezultat, pra një rritje prej 26 pikë përqindjeje. Nga viti 2016 në 2017, rritja ishte për tre pikë përqindjeje.

Nga komunat të cilat janë vlerësuar në indeksin 2017, progresin më të madh në 2018, e kanë komuna e Mamushës, Ferizajt, Pejës, Vushtrrisë dhe Obiliqit. Rritja e pikëve të mbledhura në indeksin e vitit 2018 vie si rezultat i disa elementeve, sikurse rritjes së numrit të dokumenteve buxhetore publikuara; përmirësimit të formatit të publikimit, për shembull nga PDF në MS Excel; si dhe nga përgjigjet në kërkesat tonë. Ndërsa, ka edhe komuna që kanë shënuar regres në transparencë buxhetore nga viti 2017 në 2018. Disa nga komunat të cilat kanë publikuar më pak dokumente, në formate që marrin më pak pikë, apo kanë mbajtur më pak dëgjime buxhetore me qytetarë këtë vit sesa në të kaluarin janë komuna e Parteshit, Shtimes, Ranillugut dhe Zubin Potokut. Disa komuna në fund të Tabelës 4 janë ranguar më poshtë se vitin e kaluar për shkak të klasifikimit të rëndomtë (automatik) të komunave që kanë nga zero pikë në të dy vitet. Po ashtu, siç vërehet në tabelë, dallimi në pikë të indeksit në disa raste është pozitiv, por rangimi është më i ulët për shkak të suksesit më të madh të komunave tjera.

Tabela 4. Dallimi i komunave me progres më të madh dhe regres në rangimin e indeksit të transparencës buxhetore 2017-2018

Komuna	Rangimi 2017	Rangimi 2018	Dallimi në rangim	Dallimi në pikë
Gjakova	2	1	1 ▲	26
Kamenica	7	2	5 ▲	27.5
Gjilani	17	3	14 ▲	28.5
Hani i Elezit	13	4	9 ▲	24
Shtimja	1	5	4 ▼	-8
Lipjani	6	6	0 -	15
Prishtina	5	7	2 ▼	10
Mitrovica	3	8	5 ▼	6
Peja	23	9	14 ▲	36
Prizreni	4	10	6 ▼	4.5
Suhareka	11	11	0 -	12
Vushtrria	24	12	12 ▲	35
Drenasi	8	13	5 ▼	7.5
Obiliqi	26	14	12 ▲	32.5
Skënderaj	9	15	6 ▼	5
Fushë Kosova	12	16	4 ▼	9
Istogu	10	17	7 ▼	5
Kaçaniku	19	18	1 ▲	15.5
Rahoveci	16	19	3 ▼	13.5
Vitia	14	20	6 ▼	10
Malisheva	15	21	6 ▼	8.5
Dragashi	20	22	2 ▼	18.5
Klina	22	23	1 ▼	21.5
Graçanica	21	24	3 ▼	15
Ferizaj	33	25	8 ▲	46
Mamusha	36	26	10 ▲	52
Podujeva	18	27	9 ▼	2.5
Juniku	29	28	1 ▲	18.5
Ranillugu	25	29	4 ▼	-2.5
Shtërpca	28	30	2 ▼	5
Mitrovica e Veriut	30	31	1 ▼	3.5
Deçani	27	32	5 ▼	-2
Klllokoti	35	33	2 ▲	10
Novobërda	32	34	2 ▼	2.5
Zubin Potok	31	35	4 ▼	-18
Parteshi	34	36	2 ▼	-7.5
Leposaviqi	37	37	0 -	0
Zveçani	36	38	0 -	0

Që nga krjimi i indeksit të GAP për transparencë buxhetore në vitin 2017 duke marrë për bazë vlerësimin e transparencës të vitit paraprak fiskal (2016), komunat e Kosovës kanë bërë hapa përpara në këtë aspekt. Në tabelën e mëposhtme janë përfshirë vetëm dokumentet që janë marrë për bazë në të tri vitet në mënyrë që të jenë të krahasueshme. Në vitin 2017 janë publikuar më pak lista të përfituesve të subvencioneve dhe kartela analitike të kontos sesa më 2016. Por, krahasuar me vitin 2017, në vitin 2018 është rritur numri i publikimeve të të gjitha dokumenteve. Po ashtu, transparenca buxhetore është rritur më së shumti përmes numrit të dëgjimeve buxhetore që është rritur për 18 sosh.

Tabela 5. Progresi i publikimit të dokumenteve buxhetore dhe mbajtjes së dëgjimeve buxhetore nga 2016-2018 në nivel të tërësishëm komunal

Dokumenti	2016	2017	2018	Dallimi
Raporti financiar TM 1 për vitin aktual	25	25	30	5
Raporti financiar TM 2 për vitin aktual	25	27	29	2
Raporti financiar TM 3 për vitin aktual	23	23	29	6
Raporti vjetor financiar për vitin aktual	27	28	33	5
Buxheti i planifikuar për vitin pasardhës	24	29	30	1
Korniza Afatmesme Buxhetore për tri vitet e ardhshme	22	22	30	8
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	23	28	30	2
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin aktual	23	21	27	6
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin aktual	6	4	8	4
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit pasardhës	87	91	109	18

Përfundime dhe rekomandime

Të gjeturat e indeksit të Institutit GAP për transparencë buxhetore tregojnë se në vitin 2018 komunat kanë publikuar një numër më të madh të dokumenteve buxhetore dhe kanë organizuar më shumë dëgjime buxhetore sesa në dy vitet e kaluara. Pra, vërehet një trend pozitiv i hapjes së komunave sa i përket mënyrës së publikimit të shpenzimeve të parasë publike. Po ashtu, edhe pse ende në numër të vogël, një numër më i madh i komunave janë duke publikuar dokumente shumë të rëndësishme buxhetore sikurse Kartela Analitike e Kontos. Konkretisht, më 2018 vërehet një nivel mbi mesatar i transparencës buxhetore të komunave, ku 27 nga 38 komuna kanë mbledhur 50 pikë ose më shumë në indeks. Më 2017, vetëm 17 nga 38 komuna kishin mbledhur 50 pikë ose më shumë në indeks, ndërsa më 2016 vetëm 16 nga 38 komuna e kishin arritur këtë rezultat. Por, përkundër obligimeve ligjore, një numër i konsiderueshëm i komunave vazhdojnë të mos i publikojnë dokumentet buxhetore siç kërkon legjislacioni në fuqi, konkretisht udhëzimi administrativ i MAPL për transparencë në komuna.

Për të rritur transparencën buxhetore në komuna është e rëndësishme që:

- Përveç publikimit të dokumenteve, komunat duhet t'i kushtojnë rëndësi edhe formatit në të cilin i publikojnë dokumentet buxhetore. Të njëjtat duhet të jenë publikuara në format të lexueshëm nga kompjuteri (për shembull Excel), në mënyrë që të ua lehtësojnë qytetarëve qasjen dhe përdorimin e të dhënave;
- MAPL duhet të monitorojë dhe nxisë implementimin e Udhëzimit Administrativ nr. 04/2018 për transparencë në komuna, konkretisht a) për të vlerësuar nëse janë duke u publikuar dokumentet e kërkuara buxhetore nga komunat, dhe b) nëse të njëjtat janë publikuar në bazë të fushave;
- Komunat duhet të angazhohen më shumë për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjime buxhetore dhe duhet të publikojnë procesverbalet e dëgjimeve buxhetore.

Komuna e Gjakovës

Rangimi në indeksin e transparencës 2018:	1
Numri i Pikëve:	97/100

Bazuar në indeksin e GAP për transparencë buxhetore, komuna e Gjakovës është ranguar si komuna më transparente për vitin 2018 me gjithsej 97 pikë të mbledhura. Të gjitha dokumentet e vlerësuara me pikë në indeks janë publikuar në faqen zyrtare të komunës në internet dhe pjesa më e madhe janë në formatin “Excel”, i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave publikuara. Po ashtu, Komuna e Gjakovës ka publikuar Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021 në formatin “PDF” dhe shumicën e kontratave të nënshkruara në “PDF të skanuar”, çfarë e bën më të vështirë përdorimin e informacioneve në këto dokumente nga qytetarët. Komuna e Gjakovës e ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore. Po ashtu, komuna e ka publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe ka organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2019.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesat për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 1. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Gjakovës

Dokumenti	Pikët			
	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	0	0	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	10	0	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	20	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	0	7	0	0
Kontratat e nënshkruara 2018	0	0	10	0
Totali	80	7	10	0
				97

Komuna e Kamenicës

Rangimi në indeksin e transparencës 2018:	2
Numri i Pikëve:	88/100

Bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, komuna e Kamenicës bën pjesë në kuartilin e lartë që në indeks marrin më shumë se 71 pikë. Komuna e Kamenicës ka publikuar në faqen zyrtare të komunës raportin vjetor financiar, buxhetin e planifikuar për vitin 2019, njërin raport financiar TM1 si dhe Kartelën Analitike të Kontos si një ndër dokumentet më të detajuara për shpenzimet buxhetore në formatin 'Excel'. Kjo komunë ka publikuar raportin financiar TM2 dhe listën e përfituesve të subvencioneve në formatin 'PDF', ndërsa raporti financiar TM3, Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021 dhe shumica e kontratave të nënshkruara janë publikuara në formatin 'PDF e skanuar' që e bëjnë më të vështirë përdorimin e informacioneve që këto dokumente përmbajnë nga palët e interesuara. Komuna e Kamenicës ka organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2019.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesat për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 2. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Kamenicës

Dokumenti	Pikët			
	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	0	0	2.5	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	0	3.5	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	0	0	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	0	7	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	20	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	0	0	5	0
Kontratave të nënshkruara 2018	0	0	10	0
Totali	60	10.5	17.5	0
				88

Komuna e Gjilanit

Rangimi në indeksin e transparencës 2018:	3
Numri i Pikëve:	78.5/100

Komuna e Gjilanit bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, bën pjesë në kuartilin e lartë me më shumë se 71 pikë dhe është renditur si komuna e tretë më transparente për vitin 2018. Komuna e Gjilanit pjesën më të madhe të dokumenteve buxhetore si: raportet financiare TM1 dhe TM2, raportin vjetor financiar, listën e përfituesve të subvencioneve, dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021 i ka publikuar në formatin 'Excel'. Ndërsa, raportin financiar TM3, dhe shumicën e kontratave të nënshkruara i ka publikuar në formatin 'PDF' ose 'PDF e skanuar', që e bëjnë më të vështirë përdorimin e të dhënave nga palët e interesuara.

Komuna e Gjilanit ka publikuar rregulloren për ndarjen e subvencionve si dhe ka njoftuar në faqen e zyrtare të saj për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2019. Ndërsa, nuk ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimit të buxhetit.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesat për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 3. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Gjilanit

Dokumenti	Pikët			
	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	0	3.5	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	0	0	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	10	0	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	10	0	0	0
Kontratat e nënshkruara 2018	0	0	10	0
Totali	65	3.5	10	0
				78.5

Komuna e Hanit të Elezit

Rangimi në indeksin e transparencës 2018:	4
Numri i Pikëve:	77.5/100

Në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore të komunave, komuna e Hanit të Elezit bën pjesë në kuartilin e lartë që në indeks marrin më shumë se 71 pikë. Komuna e Hanit të Elezit ka publikuar raportin vjetor financiar dhe buxhetin e planifikuar 2019 në formatin 'Excel', ndërsa raportet financiare tremujore dhe Kornizën e Afatmesme Buxhetore 2019-2021 në formatin 'PDF', që e bën më të vështirë përdorimin e të dhënave nga palët e interesuara. Kjo komunë është përgjigjur pozitivisht kërkesës së Institutit GAP duke lejuar qasje në këto dokumente si: listën e përfituesve të subvencioneve dhe Kartelën Analitike të Kontos si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimet të buxhetit.

Komuna e Hanit të Elezit ka publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve, kontratat e nënshkruara 2018 dhe ka organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2019.

Tabela 4. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Hanit të Elezit

Dokumenti	Pikët			
	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	0	3.5	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	0	3.5	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	0	3.5	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	0	0	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	0	0	0	5
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	0	0	0	10
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	0	7	0	0
Kontratat e nënshkruara 2018	0	0	10	0
Totali	35	17.5	10	15
				77.5

Komuna e Shtimes

Rangimi në indeksin e transparencës 2018:	5
Numri i Pikëve:	77.5/100

Duke u bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, Komuna e Shtimes bën pjesë në kuartilin e lartë që në indeks marrin 71 pikë apo më shumë. Komuna e Shtimes pjesën më të madhe të dokumenteve buxhetore të përfshira në indeks si: raportet tremujore, raportin financiar vjetor, buxhetin e planifikuar për vitin 2019, listën e përfituesve të subvencioneve dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021 i ka publikuar në formatin 'Excel'. Ndërsa, shumicën e kontratave të nënshkruara i ka publikuar në formatin 'PDF e skanuar' që e bën më të vështirë përdorimin e të dhënave nga palët e interesuara.

Komuna e Shtimes ka publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve si dhe ka njoftuar në faqen e saj zyrtare për mbajtjen e tre dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2019. Kjo komunë nuk e ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimit të buxhetit.

Komuna e Shtimes është përgjigjur në kërkesat për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 5. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Shtimes

Dokumenti	Pikët			
	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	0	0	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	10	0	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	0	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	10	0	0	0
Kontratave të nënshkruara 2018	0	0	10	0
Totali	67.5	0	10	0
				77.5

Komuna e Lipjanit

Rangimi në indeksin e transparencës 2018:	6
Numri i Pikëve:	77/100

Bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, komuna e Lipjanit bën pjesë në kuartilin e lartë që në indeks përfshijnë 71 pikë apo më shumë. Kjo komunë ka publikuar pjesën më të madhe të dokumenteve buxhetore si: raportet tremujore, raportin vjetor financiar, buxhetin e planifikuar për vitin 2019, si dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021 në formatin 'Excel'. Ndërsa listën e përfituesve të subvencioneve dhe shumicën e kontratave të nënshkruara i ka publikuar në formatin 'PDF' ose 'PDF e skanuar' që e bëjnë më të komplikuar përdorimin e këtyre të dhënave nga qytetarët. Kjo komunë ka publikuar edhe rregulloren për ndarjen e subvencionve dhe ka organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2019.

Kjo komunë nuk ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimit të buxhetit.

Komuna e Lipjanit është përgjigjur në kërkesat për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 6. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Lipjanit

Dokumenti	Pikët			
	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	0	0	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	0	7	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	10	0	0	0
Kontratat e nënshkruara 2018	0	0	10	0
Totali	60	7	10	0

77

Komuna e Prishtinës

Rangimi në indeksin e transparencës 2018:	7
Numri i Pikëve:	77/100

Bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, komuna e Prishtinës bën pjesë në kuartilin e lartë që në indeks marrin më shumë se 71 pikë. Kjo komunë ka publikuar dokumentet buxhetore si: raportet tremujore, raportin financiar vjetor, buxhetin e planifikuar për vitin 2019, listën e përfituesve të subvencioneve në formatin 'Excel', i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave publikuara. Kurse, Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021 e ka publikuar në formatin 'PDF' dhe shumicën e kontratave të nënshkruara në formatin 'PDF e skanuar', që e bëjnë më të vështirë përdorimin e të dhënave për palët e interesuara.

Komuna e Prishtinës ka publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe ka njoftuar në faqen zyrtare të saj për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2019. Ndërsa, nuk ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos si një ndër dokumentet më të detajuara për shpenzimet buxhetore.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesat për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 7. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Prishtinës

Dokumenti	Pikët			
	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	0	0	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	10	0	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	0	7	0	0
Kontratat e nënshkruara 2018	0	0	10	0
Totali	60	7	10	0

77

Komuna e Mitrovicës

Rangimi në indeksin e transparencës 2018:	8
Numri i Pikëve:	75.5/100

Bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, komuna e Mitrovicës bën pjesë në kuartilin e lartë që në indeks marrin më shumë se 71 pikë. Të gjitha dokumentet e vlerësuara me pikë në indeks janë publikuara në faqen zyrtare të komunës. Dokumentet buxhetore si: raportin vjetor financiar, buxhetin e planifikuar për vitin 2019 janë publikuar në formatin 'Excel'. Ndërsa pjesa më e madhe e dokumenteve si: raportet tremujore, lista e përfituesve të subvencioneve, Kartela Analitike e Kontos si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimit të buxhetit, Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021 dhe shumica e kontratave të nënshkruara janë publikuara në formatin 'PDF' ose 'PDF e skanuar', që e bëjnë më të vështirë përdorimin e të dhënave nga qytetarët.

Kjo komunë, ka publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe ka njoftuar në faqen zyrtare të saj për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2019.

Komuna e Mitrovicës është përgjegjës në kërkesat për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 8. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Mitrovicës

Dokumenti	Pikët			
	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	0	0	2.5	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	0	0	2.5	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	0	3.5	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	0	0	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	0	0	5	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	0	0	10	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	0	7	0	0
Kontratat e nënshkruara 2018	0	0	10	0
Totali	35	10.5	30	0
				75.5

Komuna e Pejës

Rangimi në indeksin e transparencës 2018:	9
Numri i Pikëve:	73.5/100

Komuna e Pejës bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore bën pjesë në kuartilin e lartë që në indeks kanë më shumë se 71 pikë. Dokumentet buxhetore si: raportet tremujore, raporti financiar vjetor, dhe Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021 janë publikuara në formatin 'Excel'. Kurse, buxheti i planifikuar për vitin 2019, lista e përfituesve të subvencioneve dhe shumica e kontratave të nënshkruara janë publikuara në formatin 'PDF' dhe 'PDF e skanuar', të cilat e bëjnë më të vështirë përdorimin e informacioneve që këto dokumente përmbajnë nga palët e interesuara.

Komuna e Pejës ka publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe ka njoftuar në faqen zyrtare të saj për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2019. Ndërsa, nuk ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos si një ndër dokumentet më të detajuara për shpenzime buxhetore.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesat për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 9. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Pejës

Dokumenti	Pikët			
	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	0	3.5	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	0	0	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	0	0	5	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	10	0	0	0
Kontratave të nënshkruara 2018	0	0	10	0
Totali	55	3.5	15	0
				73.5

Komuna e Prizrenit

Rangimi në indeksin e transparencës 2018:	10
Numri i Pikëve:	71.5/100

Bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, komuna e Prizrenit bën pjesë në kuartilin e lartë që në indeks marrin më shumë se 71 pikë. Kjo komunë ka publikuar në faqen zyrtare të saj dokumentet buxhetore si: raportin vjetor financiar, buxhetin e planifikuar për vitin 2019, dhe listën e përfituesve të subvencioneve në formatin 'Excel' i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave publikuara. Kurse, dokumentet buxhetore si: raportet financiare TM1 dhe TM3, Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021 dhe shumicën e kontratave të nënshkruara i ka publikuara në formatin 'PDF' dhe Kartelën Analitike të Kontos si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimit të buxhetit në formatin 'PDF e skanuar', që e vështirësojnë përdorimin e informacioneve të këtyre dokumenteve nga palët e interesuara.

Komuna e Prizrenit ka publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe ka njoftuar në faqen zyrtare të saj për mbajtjen e vetëm një dëgjimi buxhetor me qytetarët për buxhetin e vitit 2019. Ndërsa nuk ka publikuar raportin financiar TM2.

Kjo komunë nuk është përgjigjur në kërkesën për qasje në informacione të përcjellur nga Instituti GAP.

Tabela 10. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Prizrenit

Dokumenti	Pikët			
	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	0	3.5	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	0	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	0	3.5	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	0	0	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	10	0	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	0	0	10	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	0	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	0	7	0	0
Kontratat e nënshkruara 2018	0	10	0	0
Totali	37.5	24	10	0
				71.5

Komuna e Vushtrrisë

Rangimi në indeksin e transparencës 2018:	11
Numri i Pikëve:	69.5/100

Në bazë të indeksit të Institutit GAP për transparencë buxhetore, komuna e Vushtrrisë bën pjesë në kuartilin e mesëm të lartë që në indeks marrin 71 pikë apo më pak. Komuna e Vushtrrisë ka publikuar në faqen e saj zyrtare raportin vjetor financiar dhe buxhetin e planifikuar për vitin 2019 në formatin 'Excel'. Kurse, pjesën më të madhe të dokumenteve buxhetore si: raportet tremujore, listën e përfituesve të subvencioneve, Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021 i ka publikuar në formatin 'PDF' që e vështirëson përdorimin e informacioneve të këtyre dokumenteve nga palët e interesuara. Kjo komunë gjithashtu ka publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e nënshkruara 2018, si dhe ka organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2019. Komuna e Vushtrrisë nuk ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimit të buxhetit.

Kjo komunë nuk është përgjigjur në kërkesën për qasje në informacione të përcjellur nga Instituti GAP.

Tabela 11. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Vushtrrisë

Dokumenti	Pikët			
	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	0	3.5	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	0	3.5	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	0	3.5	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	0	0	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	0	7	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	0	7	0	0
Kontratat e nënshkruara 2018	0	0	10	0
Totali	35	24.5	10	0

Komuna e Suharekës

Rangimi në indeksin e transparencës 2018:	12
Numri i Pikëve:	69.5/100

Komuna e Suharekës në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore bën pjesë në kuartilin e mesëm të lartë që në indeks marrin 71 pikë apo më pak. Kjo komunë ka publikuar në faqen zyrtare të komunës raportin financiar TM3 dhe raportin financiar vjetor në formatin 'Excel'. Ndërsa, dokumentet e tjera buxhetore të përfshira në indeks si: raportet financiare TM2 dhe TM3, buxhetin e planifikuar për vitin 2019, listën e përfituesve të subvencioneve, Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021 i ka publikuar në formatin 'PDF' dhe shumicën e kontratave të nënshkruara si 'PDF e skanuar', që e bëjnë më të vështirë përdorimin e këtyre informacioneve nga palët e interesuara. Komuna e Suharekës ka publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe ka organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2019.

Kjo komunë nuk ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimit të buxhetit.

Komuna e Suharekës nuk është përgjigjur në kërkesën për qasje në informacione të përcjellur nga Instituti GAP.

Tabela 12. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Suharekës

Dokumenti	Pikët			
	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2018	0	3.5	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2018	0	3.5	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2018	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2018	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2019	0	3.5	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	0	0	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018	0	7	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2018	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2019	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021	0	7	0	0
Kontratat e nënshkruara 2018	0	0	10	0
Totali	35	24.5	10	0

69.5

Komuna e Drenasit

Rangimi në indeksin e transparencës 2018:	13
Numri i Pikëve:	67.5/100

Duke u bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, komuna e Drenasit bën pjesë në kuartilin e mesëm të lartë që në indeks marrin 71 pikë apo më pak. Komuna e Drenasit ka publikuar në faqen zyrtare të komunës raportin vjetor financiar, buxhetin e planifikuar për vitin 2019, dhe listën e përfituesve të subvencioneve në formatin 'Excel'. Ndërsa, raportet tremujore, Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021, dhe shumicën e kontratave të nënshkruara i ka publikuar në formatin 'PDF e skanuar', çfarë e bën më të komplikuar përdorimin e këtyre të dhënave nga qytetarët. Komuna e Drenasit ka publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe ka organizuar së paku katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2019.

Kjo komunë nuk ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimit të buxhetit.

